



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijemeno / Prodato Received / Delivery	17. 08. 2023	vin dual yehi	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRINSHCK	5709/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.905/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.905/2023 të datës 04.07.2023 të parashtruar nga ankuesja . . . të cilën me autorizim e përfaqësojnë Avokatët Florim H. Shefqeti dhe Bedri Abdullahu me adresë: Rruga . . . në Prishtinë, kundër Vendimit ASHNA-KD002/2023 të datës 05.06.2023 Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancë të përbashkët për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 17.08.2023, mori këtë vendim:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.905/2023 të datës 04.07.2023, të parashtruar nga ankuesja . . .

A r s y e t i m

Ankuesja . . . përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë 04.07.2023 përmes poste ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.905/2023 me numër protokoll:5008/2023, kundër Vendimit ASHNA-KD002/2023 të datës 05.06.2023 Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.07.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e . . .

ankuesit nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Ndërsa Këshilli më datë 19.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës të plotësuar edhe përmes shkresës së datës 26.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.07.2023 me Nr.prot:5008/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 10.05.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.07.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 27.07.2023; Aktvendimin A.nr.1318/2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Shkresën e datës 19.07.2023 dërguar nga ASHNA për Këshillin; Akt emërimit të ankueses të datës 27.03.2017 me përshkrimin e detyrave të punës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.01.2023; E-mailin e datës 18.05.2023 dërguar nga G.B për ankuesen; E-mailin e datës 26.04.2023 dërguar nga S. B për Komisionin Disiplinor; Vendimin e datës 01.04.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 05.06.2023; E-mailin e datës 26.05.2023 dërguar nga G. B për ankuesen; Procesverbali i seancave të Komisionit Disiplinor i datës 17.05.2023; Procesverbali i seancave të Komisionit Disiplinor i datës 23.05.2023; E-mailin e datës 02.06.2023 dërguar nga G. B për komisionin disiplinor; E-mailin e datës 31.05.2023 dërguar nga G. B për komisionin disiplinor; E-mailin e datës 23.05.2023 dërguar nga G. B për komisionin disiplinor; E-mailin e datës 05.06.2023 dërguar nga G. B për komisionin disiplinor; E-mailin e datës 10.05.2023 dërguar nga G. B për ankuesen; E-mailin e datës 12.05.2023 dërguar nga G. B për ankuesen; E-mailin e datës 19.05.2023 dërguar nga G. B për ankuesen i orës 10:56 AM; E-mailin e datës 19.05.2023 dërguar nga G. B për ankuesen i orës 11:01 AM; E-mailin e datës 30.05.2023 dërguar nga G. B për ankuesen; E-mailin e datës 01.06.2023 dërguar nga G. B për ankuesen; E-mailin e datës 26.04.2023 dërguar nga S. B për Komisionin Disiplinor; Shkresën e datës 16.03.2023 të titulluar "Shënime nga takimi i dytë i Komitetit të Auditimit"; Shkresën e datës 04.04.2023 të përfaqësuesve të palës dërguar ASHNA-së; E-mailin e datës 28.02.2023 dërguar nga S. B për ankuesen; E-mailin e datës 15.02.2023 dërguar nga ankuesja për B.Z me korrespondencën e bashkangjitur prej gjashtë (6) faqesh; E-mailin e datës 09.03.2021 dërguar nga D.U për M.Gj me korrespondencën e bashkangjitur prej katër (4) faqesh; E-mailin e datës 02.11.2021 dërguar nga Rr. Z për D.U me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; Vendimin e Këshillit A.nr.517/2022 të datës 01.07.2022; Vendimin e Këshillit A.nr.1196/2021 të datës 13.01.2022; E-mailin e datës 18.05.2023 dërguar nga D. U për G.B me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; Vendimin e datës 06.07.2023 të komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesën e ankueses të datës 19.06.2023 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të ASHNA-së; Vendimin e Drejtorit të ASHNA-së të datës 29.06.2023; E-mailin e datës 22.05.2023 me korrespondencën e bashkangjitur prej gjashtë (6) faqesh.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja . **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit të datës 01.04.2017 ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në mban pozitën e punës "Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm", ndërsa ndaj të njëjtës Komisioni Disiplinor pas zhvillimit të procedurës disiplinore përmes vendimit me shifër KD002/2023 të datës 05.06.2023 duke i shqiptuar masën



disiplinore "Ndalim të 30% pagës për periudhën prej 6 muaj" për shkak të shkeljeve të dispozitave të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Këshilli i Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në praktiken vendimmarrëse duke vendosur sipas Vendimit A.nr.857/2021 të datës 01.12.2021, ka kërkuar me datë 19.11.2021 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/DMZP informata lidhur me statusin e të punësuarve në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror, kurse DMZP në po të njëjtën datë ka informuar KPMSHCK-në se më datë 02.03.2021 ka bërë njoftimin për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror se të punësuarit në këtë institucion kanë statusin e Shërbyesve Publik.

Lidhur kompetencën e shqyrtimit të ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"* dhe si rrjedhojë duke u bazuar edhe në njoftimin e datës 02.03.2021 të DMZP-së lidhur me konfirmimin se të punësuarit në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror e kanë statusin e nëpunësve të Shërbimit Publik, Kolegji i Këshillit ka ardhur në konstatimin se ankuesja Xhyldane Kiçmari nuk e ka statusin e nëpunësit të Shërbimit Civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e Nëpunësve Civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesja ka statusin e nëpunësit të Shërbimit Publik, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.905/2023 e datës 04.07.2023 të parashtuar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe e Ankesave, duke marr për bazë dispozitat e nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"*, konstaton faktin se zyrtarët publik me status te nëpunësve të Shërbimit Publik kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente, ndërsa nga shkresat e lëndës Komisioni Disiplinor vërehet qartë se përmes Vendimit me shifër KD002/2023 të datës 05.06.2023 e ka udhëzuar drejtë palën në mjete juridike, respektivisht e ka udhëzuar të njëjtën se kundër vendimit të Komisionit Disiplinor pala ka të drejtë të parashtrojë ankesë të brendshme tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të ASHNA-së.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës të ofruara nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror përmes shkresës së datës 19.07.2023 dëshmohet fakti se ankuesja ka parashtuar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave kundër Vendimit me shifër KD002/2023 të datës 05.06.2023, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave përmes Vendimit KA-Nr.003/2023 të datës 06.07.2023 e ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankueses të datës 19.06.2023, duke e udhëzuar palën në mjete juridike pranë Gjykatës kompetente, ndërsa përmes shkresës së datës 26.07.2023 të përcjellë në Këshill nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë të

Shërbimeve të Navigacionit Ajror, konstatohet fakti se sipas Aktvendimit A.nr.1318/2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ankuesja ka hapur konflikt administrativ kundër Vendimit KA-Nr.003/2023 të datës 06.07.2023 të komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, prandaj në rrethanat e rastit konkret, pavarësisht faktit që Këshilli është shpallur jo kompetent lidhur me ankesën e ankueses të datës 04.07.2023, nuk e dërgon lëndën te organi kompetent, pasi që nga arsyetimi i dhënë në këtë vendim konstatohet fakti se ankuesja i ka konsumuar hapat procedural ankimor sipas udhëzimeve të rregullta juridike sikurse përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.905/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesve të ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.